



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Gllgoc

Lista Përfundimtare e Votuesve

2016

PËRMBAJTJA

QËLLIMI.....	3
PËRMBLEDHJE.....	3
PËRSHKRIM.....	4
PRANIMI I SHKRESËS NGA KËSHILLIT GJYQËSORË.....	4
PERIUDHA E SHËRBIMIT TË VOTUESVE.....	5
PERIUDHA E KUNDËRSHTIMIT DHE KONFIRMIMIT.....	6
VOTIMI JASHTË KOSOVËS.....	6
KRIJIMI I LISTËS PËRFUNDIMTARE TË VOTUESVE.....	6
REKOMANDIMET PËR AGJENCINË E REGJISTRIMIT CIVIL.....	7
PËRMBLEDHJE TABELORE	
(Numri i votuesve, numri i QV, numri i VV dhe numri i votuesve për qendra të votimit).....	7

SHTOJCA 1: Shembull se si duken faqet e Listës Përfundimtare të Votuesve për vendvotimin e rregullt.

SHTOJCA 2: Shembull se si duken faqet e Listës Përfundimtare të Votuesve për vendvotimin e dyfishtë.

Qëllimi

Në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është e obliguar që të certifikoj listën e votuesve në raport me zgjedhjet e caktuara¹. Ky dokument e mbështetë procesin e certifikimit të listës së votuesve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datën 11 qershor 2017.

Përmbledhje

Lista Përfundimtare e Votuesve (**LPV 2017**) për Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës bazohet në Ekstraktin e Regjistrimit Qendror Civil². Ky ekstrakt është përpiluar nga Agjencia e Regjistrimit Civil, gjegjësisht Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve (DPA), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Lista Përfundimtare e Votuesve 207 për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës përmban **0,000,000 emra të votuesve**, me një rritje prej **0,000 votues apo 0,000%** në krahasim me zgjedhjet e fundit për të njëjtën komunë.

- Numri i Qendrave të Votimit (QV) është njëzet e tetë (28). Katër (4) qendra të votimit më shumë se në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2014, për komunën e Glllogocit, dhe
- Numri i vendvotimeve është shtatë dhjetë e dy (72). Gjashtë (6) vendvotime më shumë se në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2014, për komunën e Glllogocit.

¹ Ligji Nr. 03/L-256, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 64.2, pika (g).

² Ibid, Neni 7.1, pika (a) dhe (b).

Përshkrimi

Pas pranimit të ekstraktit nga Regjistri Qendror Civil³, Divizioni i Shërbimit të Votuesve para se të fillojë caktimin e votuesve në Qendra të Votimit, ka bërë caktimin e votuesve të rinj në Qendra të Votimit në mënyrë automatike dhe manuale (Votuesit e vjetër që kanë votuar në mënyrë të rregullt në Qendrat e tyre të votimit nuk janë prekur).

Numri i votuesve të rinj që do të votojnë për herë të parë në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Komunën e Glllogocit do të mbahen me 4 Dhjetor 2016 është: **4, 568 votues**.

- a) **3,143 votues** të rinj që pas Zgjedhjeve Parlamentare 2014 kanë arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç dhe që do të votojnë për herë të parë në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Glllogocit më 4 Dhjetor 2016⁴.
- b) **1, 425 votues** që nuk kanë qenë në Listën Përfundimtare të Votuesve të 2014-tës për Komunën e Glllogocit, e që mund të konsiderohen si votues të regjistruar për herë të parë në Regjistrin Qendror Civil midis dy palë zgjedhjesh dhe votues që kanë ndërruar adresë nga komunat tjera dhe janë regjistruar si banorë të komunës së Glllogocit.
- c) Numri i emrave të personave të vdekur dhe atyre që kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës dhe që vendbanimin e kanë pasur të komunës së Glllogocit është: **1, 006 emra të votuesve**.
- d) Numri i votuesve që kanë ndërruar adresë jashtë komunës së Glllogocit pas Zgjedhjeve Parlamentare 2014, është: **1,224 votues**.

Pranimi i Shkresës nga Këshilli Gjyqësorë i Republikës së Kosovës

Bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr. 02/ 2013, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, para fillimit të Periudhës së Konfirmimit dhe Kundërshtimit të Listës së

³ Rregulla Zgjedhore Nr. 2/2013, Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës së Votuesve, Neni 3.2 dhe 3.3.

⁴ Votuesit, të cilët kanë mbushur moshën 18 vjeç prej datës 9 qershor 2014 (pas datës së Zgjedhjeve Parlamentare që janë mbajtur me datën 8 qershor 2016) dhe që do t'i mbushin 18 vjeç me datën 4 dhjetor 2016.

Votuesve, me datën 15 nëntor 2016, nga Këshillit Gjyqësor i Republikës së Kosovës ka pranuar listën me njëzet e dy (22) emra të personave që u është marrë zotësia e veprimit me vendim gjyqësorë nga Gjykata Themelore Prishtinë – Dega në Gllogoc⁵.

Pas analizimit të këtyre të dhënave, Divizioni i Shërbimit të Votuesve ka identifikuar shtatë (7) persona të cilët janë larguar nga Lista e Votuesve⁶, për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Gllogoc. Ndërsa, për 15 persona nuk është mundur të bëhet identifikimi, për shkak që nuk kanë poseduar të dhëna të mjaftueshme si: datën e lindjes dhe numrin personal të identifikimit (kanë pasur vetëm emrin dhe mbiemrin) ose nuk janë gjendur në fare në listën e votuesve me të dhënat që kanë poseduar.

Periudha e shërbimit të votuesve

Periudha e Shërbimit të Votuesve ka filluar me datën 10 nëntor 2016 dhe ka përfunduar me datën 22 nëntor 2013⁷.

Gjatë kësaj kohe, të gjithë votuesit e komunës së Gllogocit kanë pasur mundësi të informohen se në cilën qendër të votimit janë caktuar të votojnë ose të kërkojnë rri-caktim të qendrës së votimit më të përshtatshme për ta.

Gjatë kësaj periudhe, **56 votues** kanë parashtruar kërkesë për ndërrim të Qendrave të Votimit në zyrën e KKZ-së.

- Janë aprovuar 54 kërkesa për ndërrim të qendrës së votimit.
- Janë refuzuar 2 kërkesa për ndërrimin e qendrës së votimit⁸.

Pas kësaj periudhe, Divizioni i Shërbimit të Votuesve ka vendosur të gjitha ndryshimet në listën e votuesve, e cila më pas është integruar në ekstraktin e fundit që është pranuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil/ Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve.

⁵ Rregulla Zgjedhore Nr. 02/2013 Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimit i Listës së Votuesve, Neni 3.5 dhe neni 3.6.

⁶ Ligji Nr. 03/L-256, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 5.2, pika (c).

⁷ Vendimi Nr. 893-2016, për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore sipas Rregullës Zgjedhore nr. 15/ 2013për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parakohshme II/ pika (1).

⁸ Dy (2) kërkesat për ndërrim të QV-ve janë refuzuar me arsyetimin, për shkak që votuesit kanë kërkuar ndërrim të qendrave të votimit nga qendra split e votimit 0301X në Qendrën e Votimit 0301E, ku ndarja e votuesve në këto qendra të votimit bëhet në bazë të renditjes alfabetike të shkronjave të mbiemrit.

Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit

Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit të Listës së Votuesve është zhvilluar nga data 18 Nëntor 2016 deri më 22 Nëntor 2016⁹, e cila i ka mundësuar të gjithë votuesve të komunës së Gllogocit që të sfidojnë LPV-në.

Sekretariati i KQZ-së, para fillimit të Periudhës së Konfirmimit dhe Kundërshtimit të Listës së Votuesve, i ka njoftuar personat kontaktues të subjekteve politike të certifikuara për zgjedhjet në Gllogoc, për tu pajisur me CD-të që kanë përmbajtur Listën Preliminare të Votuesve¹⁰.

Gjatë kësaj periudhe, asnjë votues nuk kanë konfirmuar dhe kundërshtuar të dhënat në Listën e Votuesve.

Votimi jashtë Kosovës

Programi i Votimit jashtë Kosovës, Periudha e Aplikimit për Regjistrimit është ndërmarrë në mes datës 9 Nëntor 2016 dhe 17 Nëntor 2016¹¹. Divizioni i Shërbimit të Votuesve ka dërguar 43 aplikacione për regjistrim, votuesve që në zgjedhjet e fundit kishin arritur të dëshmonin kriteret e zotësisë juridike për të votuar dhe që i përkasin Komunës së Gllogocit. Informatat e nevojshme dhe formularët për regjistrim janë publikuar në ueb faqen zyrtare të KQZ-së.

Gjatë kësaj periudhë, nuk ka pasur asnjë kërkesë për aplikim.

Krijimi i LPV-së

Pas përfundimit të Periudhës së Shërbimit të Votuesve dhe Periudhës së Konfirmimit dhe Kundërshtimit të LV-së, Divizioni për Shërbim të Votuesve i ka caktuar votuesit nëpër vendvotime sipas renditjes alfabetike. Të dhënat e reja janë shtypur në format PDF dhe kualiteti është kontrolluar nga ana e Divizionit të Shërbim të Votuesve. Këto

⁹ Vendimi Nr. 893-2016, për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore sipas Rregullës Zgjedhore nr. 15/ 2013 për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parakohshme II/ pika (a).

¹⁰ Rregulla Zgjedhore Nr.2/2013 Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës së Votuesve, Neni 5.1.

¹¹ Vendimi Nr. 893-2016, për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore sipas Rregullës Zgjedhore nr. 15/ 2013 për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parakohshme II/pika (n).

dokumente janë të gatshme për t'ju dërguar kompanisë e cila do ta bëjë shtypjen e Listës Përfundimtare të Votuesve 2016.

Rekomandimet për Agjencinë e Regjistrimit Civil/ Regjistrin Qendror Civil

Divizioni i Shërbimit të Votuesve vlerëson bashkëpunimin e ngushtë dhe profesional me Agjencinë e Regjistrimit Civil. Lidhur me proceset e ardhshme të krijimit të Listës së votuesve, Divizioni i Shërbimit të Votuesve ofron këto rekomandime:

- Gjatë krijimit të listës së votuesve, përkatësisht përgjatë marrjes së dy ekstrakteve të Regjistrin Qendror Civil, ka pasur numër të madh të votuesve që janë larguar si të vdekur. Kjo ka ngjarë pas marrjes së ekstraktit të dytë të Regjistrin Qendror Civil. Është konstatuar se të dhënat e emrave të vdekur në Departamentin e Gjendjes Civile nuk po reflektohen në mënyrë automatike në Departamentin e Prodhimit të Dokumenteve, që si departament e mirëmban ekstraktin e Regjistrin Qendror Civil. Rekomandojmë që reflektimi i të dhënave në Departamentin e Gjendjes Civile të bëhet në mënyrë automatike në Regjistrin Qendror Civil.

Përmbledhje tabelore

1. Numri i votuesve, Numri i Qendrave të Votimit dhe Numri i Vendvotimeve për Komunën e Glllogocit.

Kodi Komunal	Komuna	Numri i Votuesve	Numri i QV	Numri i VV
03	Glllogoc	52 579	28	72

2. Numri i Votuesve për Qendra të Votimit në Komunën e Glllogocit.

Kodi i Komunës	Komuna	Qendra e Votimit 2016	Qyteti/Vendi	NUMRI I VOTUESVE
3	Glllogoc	0301E	Glllogoc	3996
3	Glllogoc	0301X	Glllogoc	3163
3	Glllogoc	0302E	Komora Sn	3917
3	Glllogoc	0303E	Koreticë e Epërme	1237
3	Glllogoc	0304E	Dobrashec	1863
3	Glllogoc	0305E	Gradicë	1002
3	Glllogoc	0306E	Tërstenik	3389
3	Glllogoc	0307E	Abri e Epërme	1648
3	Glllogoc	0308E	Bajicë	1981
3	Glllogoc	0309E	Krajkovë	1882
3	Glllogoc	0310E	Nekoc	2606
3	Glllogoc	0311E	Sankofc	2694
3	Glllogoc	0312E	Likoshan	723
3	Glllogoc	0313E	Arlat	2755
3	Glllogoc	0314E	Negrovc	1667
3	Glllogoc	0315E	Poklek	1547
3	Glllogoc	0316E	Gllanasell	1611
3	Glllogoc	0317E	Llapushnik	3027
3	Glllogoc	0318E	Polluzhe	1052
3	Glllogoc	0319E	Zabeli i Ulte	1807
3	Glllogoc	0320E	Qikatove e Re	1675
3	Glllogoc	0321E	Kishnarekë	1078
3	Glllogoc	0322E	Qikatovë e Vjeter	1277
3	Glllogoc	0323E	Terdevc	1055
3	Glllogoc	0324E	Vasilevë	608
3	Glllogoc	0325E	Vërboc	1167
3	Glllogoc	0326E	Shtuticë	753
3	Glllogoc	0327E	Glllobar	1389
				TOTALI : 52569

